

## VENDIM

Nr.461, date 22.7.1998

### PER REGJISTRIN QE MBAN PUNEDHENESI PER AKSIDENTET NE PUNE DHE PER SEMUNDJET PROFESIONALE

Ne mbështetje te nenit 42 te ligjit nr.7691, date 12.7.1995 "Kodi i Punës se Republikës se Shqipërisë", me propozimin e Ministrisë se Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

#### V E N D O S I:

1. Punëdhënësi ose personi përgjegjës i ngarkuar prej tij, duhet te mbaje ne ndërmarrje regjistrin e aksidenteve ne pune dhe te sëmundjeve profesionale. Ne këtë regjistër duhet te regjistrohen te gjitha aksidentet dhe gati-aksidentet, qe ndodhin ne ndërmarrje dhe te gjitha rastet e sëmundjeve profesionale.
  2. Regjistri duhet te përmbajë këto elemente:
    - a) emrin, mbiemrin e te punësuarit;
    - b) datëlindjen;
    - c) profesionin;
    - d) repartin ku ndodh aksidenti;
    - e) datën e aksidentimit;
    - f) te gjitha aksidentet ne pune, me pasoje vdekjen;
    - g) te gjitha aksidentet ne pune, te cilat kane sjelle humbje te aftësisë për pune te punëmarrësit;
    - h) te gjitha ndodhitë ne te cilat mund te ishte shkaktuar aksidenti (gati-aksidenti);
    - i) pjesa e dëmtuar e trupit;
    - j) diagnoza e sëmundjes profesionale;
    - k) data e diagnostikimit;
    - l) faktorët shkaktues te sëmundjes ne mjediset e punës;
    - m) ditët e paaftësisë për pune për shkak te aksidentit ose sëmundjes profesionale;
    - n) masat qe duhen marre për te ardhmen.
  3. Ne rastet e dëmtimit te me shume se një punëmarrësi, regjistrimi te behet për secilin punëmarrës te dëmtuar, ne te njëjtin aksident.
  4. Çdo flete e regjistrin, përpara përdorimit te tij, te nënshkruhet nga inspektori i punës dhe duhet te ruhet nga punëdhënësi, për një periudhe 5-vjeçare. Pas kësaj periudhe këto regjistra arkivohen pranë Drejtorisë Rajonale te Sigurimeve Shoqërore.
  5. Edhe ne rastet e mbylljes se veprimtarisë para afatit 5-vjeçar dhe kryesisht ne çastin e mbylljes se veprimtarisë, punëdhënësi është i detyruar t'i arshivoje regjistrat pranë Drejtorisë Rajonale te Sigurimeve Shoqërore.
  6. Punëdhënësi është i detyruar te vere regjistrin ne dispozicion te Inspektoratit Shtetëror te Punës dhe Institutit te Sigurimeve Shoqërore, sa here qe do t'i kërkohet.
  7. Regjistri-tip hartohet nga Inspektorati Shtetëror i Punës.
- Ky vendim hyn ne fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano